



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 82-të, të mbajtur më datë 14.02.2023 morri,

VENDIM

Procedura e KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-5114/1 të datës 15.11.2021, është formuar me vetë iniciativë, për shkelje të dispozitave të nenit 82 të ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nga -----, anëtar i Këshillit-----, NDËRPRITET.

Konstatohet se pas urdhërpagesës së lëshuar kundërvajtës me numër 08-290/3, datë 02.06.2022, personi i përmendur ka vepruar, përkatësisht në të është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda e regjistruar me numër 08-5114/1 datë 15.11.2021 është formuar me vetiniciativë.

KSHPK-ja, nga inspektimi në Gazetën Zyrtare të RMV-së numër 26/2021, konstatoi se _____ me vendimin numër 14-1568/1 datë 26.01.2021 është

emëruar anëtar i Këshillit _____ dhe nuk ka dorëzuar fletë anketuese në KSHPK brenda afatit ligjor pas emërimit në detyrë.

Për sa më sipër, DHPGJS i ka lëshuar personit të përmendur një urdhërpagesë kundërvajtëse nr. 08-290/3 të datës 02.06.2022, për shkeljen e kryer nga neni 82 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, dënueshëm sipas neni 109 të të njëjtit ligj.

Nga ana e personit të caktuar në afatin e përcaktuar ligjor është vepruar sipas urdhërpagesës kundërvajtëse, përkatësisht është paguar gjysma e gjobës së përcaktuar në të.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti:A.Ç.

Miratoi: Mr. Vladimir Georgiev anëtar në KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
NËNKRYETARE,
Katica Nikolovska**